

D E K R E T
Nr.1420, datë 20.3.1996

PËR NËNSHKRIMIN E AKTEVE NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Nënshkrimi i traktateve, marrëveshjeve, protokolleve dhe akteve të tjera ndërkombëtare, në të cilat subjekte janë shteti shqiptar. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ministritë, institucionet qendrore, si dhe organet e pushtetit lokal, mund të bëhet vetëm pasi të jetë marrë pëlqimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha